



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.4/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtarë të Komisionit, në procedurë disiplinor kundër Xxxxx xxxx, gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në xxxxx-dega në Xxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-428/A, në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/14/2016, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës, në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, Hasime Osmani, dhe gjyqtarit Xxxxx xxxx, më datën 07.03.2017, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Xxxx xxxxxxx, gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në xxxxx-Dega në Xxxxxx, **është** përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-428/A, në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/14/2016, të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës.
2. Për shkak të vërtetimit të sjelljes së pahijshme, gjyqtarit Xxxxx Xxxxxx i shqiptohet masa disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për 30% në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj**, duke filluar prej muajit në vijim pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurorit Disiplinor ja ka paraqitur raportin përfundimtar me numër ZPD-2016-428/A, së bashku me shkresat e lëndës Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilin Xxxxxx xxxx, gjyqtar mbikëqyrës është i akuzuar për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës.

Hetimin disiplinor ZPD e kishte hapur sipas detyrës zyrtare bazuar në informacionet e pranuar nga emisioni "Drejtësia në Kosovë" dhe emalit të dërguar nga kryetari i Gjykata Themelore në Xxxxx, me pretendimin për sjellje të pahijshme të kryera nga gjyqtari Xxxxxx xxxxx, lidhur me dreken misterioze të gjyqtarit Xxxxxx dhe prokurorit Xxxxxx Xxxxx me të akuzuarin Xxxxxx xxxxxx, në restorantin Xxxx, përball Gj.Th. në Xxxxx, 24 orë pas fillimit të procesit gjyqësor në lëndën P.nr.331/16 në Gjykatën Themelore në Xxxxx (seancën fillestare në lëndën P.nr.331/16 e ka mbajtur një gjyqtar tjetër). Për ta vërtetuar sjelljen e pahijshme të kryer nga gjyqtari Xxxxxx Xxxxx, ZPD kishte intervistuar gjyqtarin Xxxxxx, po ashtu ka pranuar edhe deklaratën me shkrim të prokurorit Xxxxxx Xxxxx si dhe ka siguruar transkriptin e emisionit Drejtësia në Kosovë- prokurori drekon, me të akuzuarin të transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës me datë 28 tetor 2016.

Sa i përket raportit përfundimtar ZPD në fillim kishte paraqitur rekomandimin të Komisioni Disiplinor në mënyrë që Komisioni të vlerësojë se a duhet të suspendohet përkohësisht gjyqtari Xxxxxx. Komisioni e ka shtyrë vendimin për suspendim dhe e ka obliguar ZPD-ën që në afat prej 30 ditësh t'ia dërgoj Komisionit raportin përfundimtar. ZPD-ja, bazuar në përmbajtjen e emisionit Drejtësia në Kosovë dhe njoftimit të cilin ZPD e kishte pranuar përmes emalit të cilin ja kishte dërguar kryetari i Gjykatës Themelore në xxxx, ka gjetur se gjyqtari Xxxx ka bërë sjellje të pahijshme dhe jo-etike. Sjellja e pa hijshme është vërtetuar me rastin e takimit dhe drekës së organizuar nga gjyqtari xxxxx me prokurorin Xxxxxx xxxxx dhe të akuzuarin Xxxx xxxx. Kjo drekë ishte mbajtur 24 orë pasi që kishte filluar procesi gjyqësor në lëndën penale P.nr.331/16 në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Në bazë të këtyre të gjeturave të prezantuara në këtë raport përfundimtar dhe në përputhje me nenin 35 paragrafi 1 të ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ZPD i ka rekomanduar Komisionit inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtari Xxxxxx Xxxxx. Shqetësuese për ZPD-ën ka qenë edhe fjalët e gjyqtarit ku kishte deklaruar se ja kanë një gjak borxh. Atë ditë që ishte mbajtur dreka, gjyqtari kishte pasur gjykime se bashku me prokurorin Xxxx Xxxx për lëndë gjyqësore të tjera, dhe në fund të përfundimit të seancave kishte dalë për të ngrënë drekë.

Gjyqtari Xxxxxx në seancën Komisionit të mbajtur me datë 7.03.2017, ka theksuar se atë e kishte thirrur në telefon dhe e kishte njoftuar lidhur me rastin prokurori Xxxxxx Xxxxx me datë 26 tetor 2016. Ka qenë duke ardhur me veturë në Prishtinë se bashku me nënën dhe bashkëshorten e vetë, për të shkuar në spital, sepse e kishte babain në gjendje shumë të rëndë shëndetësore, në gjendje kome. Pas pak e kishte thirrur edhe një gazetar dhe e kishte pyetur lidhur me dreken e zhvilluar me prokurorin dhe të akuzuarin Xxxxxx Xxxxx, të cilin gjyqtari Xxxxxx ka deklaruar që e ka bashkëfshatar dhe mik të vëllait të tij. E kishte ndaluar veturën dhe ju kishte përgjigjur gazetarit në telefon dhe i kishte thënë që është rrugës dhe se për çdo tjetër të shkon në zyrën e tij, për shkak se kishte qenë shumë i shqetësuar për gjendjen shëndetësore të babait të tij. Të nesërmen me datë 27.11.2016 i kishte vdekur babai. Njerëzit që i kishin ardhur për ngushëllime për prindin i kishin treguar se ai kishte dalë në televizion, në emisionin drejtësia në Kosovë.

Gjyqtari Xxxxxx me tutje ka deklaruar në seancë dhe ka deklaruar para Komisionit se nuk ka pasur drek misterioze, siç e ka shkruar në raport ZPD-ja. Xxxxxx xxxxx ishte bashkëfshatar i gjyqtarit dhe mik i vëllait të tij dhe se atë ditë e kishte thirrur ne telefon për ta pyetur se si është babai i tij dhe e ka ftuar që të shkojnë bashkë në spital, mirëpo gjyqtari Xxxxxxxi kishte thënë se është në gjendje kome dhe nuk të njeh dhe se në atë rast meqë ka qenë në Xxxxxx, e ka ftuar ne restorant afër Gjykatës Themelore në xxxx për drek. Kjo ditë kur kanë hëngër drek ka qenë datë 21 tetor 2017, jo siç ZPD ka shkruar me datë 19. Sipas gjyqtarit Xxxxxx ai nuk ka qenë i njoftuar se Xxxxxx xxxxx ka qenë i akuzuar dhe se ishte gjykuar 24 orë me herët nga prokurori Visar Musa. Po ta kish ditur gjyqtari xxxxxx ka deklaruar se nuk do ta kishte ftuar prokurorin për drek. E gjithë biseda është zhvilluar lidhur me gjendjen shëndetësore të babait, asnjë bisedë tjetër nuk është zhvilluar, dreka ka qenë shume transparente dhe jo e fshehur siç është shfaqur në televizion dhe siç ZPD në raport e ka theksuar.

Sipas gjyqtarit xxxxxx, nuk qëndron pretendimi i ZPD-së se unë kam kërcënuar gazetarin duke i thënë se ma keni një gjak borxh dhe shkurtuar jetën e prindit, mendoj se mua mu ka shkurtuar një e drejtë qytetare, sepse rasti ishte iniciuar gjatë kohës se pamës se babait të tij. Unë i kërkoj falje gazetarit dhe se gjithë kjo ka ndodhur për shkak të gjendjes në të cilën kam qenë, stresit dhe shqetsimit për shkak të sëmundjes së babit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e ZPD-së theksoj se, ZPD vlerëson se gjyqtari Xxxxxx ishte i pasuksesshëm në kryerjen e funksionit gjyqësor, dhe ka bërë shkelje të kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtar sepse si gjyqtar nuk ka treguar kujdesin e duhur me rastin e ushtrimit të përgjegjësive gjyqësore. Në rastin konkret nuk ka vepruar në besimin e publikut në dinjitet, integritet si dhe me rastin e shfaqjes në emisionin drejtësia në Kosovë, shkrimeve neper portale elektronike si: gjykatësi aranzhoj dreken me prokurorin dhe të akuzuarin, si u takuar në drek i akuzuari me prokurorin, të gjitha këto kanë bërë që të dyshohet në objektivitetin, paanshmërinë dhe etikën e gjyqtarit xxxxxx. Organizimi i drekës jo formale me të akuzuarin janë veprime që kanë ndikim në zbehjen e imazhit të sistemit gjyqësor. Me veprimet e tija gjyqtari ka vendosur vetën në një situatë jo të mirë ku integriteti, seriozitet dhe dinjiteti janë dëmtuar në atë masë sa që në sy të publikut është dëmtuar rëndë sistemi i sistemit gjyqësor, dhe ka rekomanduar Komisionit që të ja shqiptoj një masë disiplinore në përputhje me rrethanat dhe nivelin e përgjegjësisë.

Gjyqtari xxxxxx në fjalën përfundimtare theksoj se të gjitha pohimet, pretendimet e ZPD-së se ai ka dëmtuar imazhin e gjyqësisë, nuk qëndrojnë për arsye se në gjykatën ku punon ai ka përkrahje dhe autoritet, se respekton KGJK-ën, gjyqësorin dhe gjyqtaret në veçanti, palët dhe barazinë e tyre.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës, parashtresat e dorëzuara nga ZPD-ja të cilat nuk kanë qenë të bashkangjitura në raportin përfundimtar. Pasi i shqyrtoj dhe

analizoj të gjitha provat, analizoj edhe deklaratën e gjyqtarit Xxxxxx xxxxx, Komisioni konstatoj se ekziston përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit.

Qëndron pretendimi i ZPD-së se dreka e gjyqtarit xxxxxxx me bashkëfshatarin dhe mikun e tij Xxxxxx xxxxxj se bashku me prokurorin Xxxxxx xxxxx, 24 orë pasi që është iniciuar procedura gjyqësore në të cilën është miku i gjyqtarit, kurse Xxxxxx xxxxx, duke vepruar si prokuror në këtë lëndë penale P.nr.331/16, paraqet shkelje e standardeve të kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtar.

Përkundër qe gjyqtari Xxxxxx në seancë theksoj pran KD-ës se ka drekuar me bashkëfshatarin dhe mikun e vëllait të tij Xxxxxx xxxxx së bashku me prokurorin Xxxxxx Xxxxx, dhe nuk ka qenë i njoftuar se miku i tij Xxxxxx xxxxxj ka pasur lëndë të prokurori xxxxxx, dhe se e gjithë biseda ishte zhvilluar lidhur me gjendjen shëndetësore të babait të tij, i cili kishte qenë shumë i sëmurë, sipas vlerësimit të Komisionit është e pahijshme qe së bashku me prokurorin, të ftoj në drek edhe mikun e tij.

Në seancën për këshillim dhe votim Komisioni njëzëri vendosi së Xxxxxx Xxxxx është përgjegjës për sjellje te pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës.

Lidhur me këtë Komisioni, në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime i shqipton masën disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për tridhjetë për qind (30%) në kohëzgjatje prej 6 muajve**, duke filluar prej muajit të ardhshëm pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Si rrethanë lehtësuesi me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, Komisioni mori parasysh gjendjen shëndetësore shumë të rëndë në të cilën kishte qenë babi i gjyqtarit Xxxxx, dhe gjendjen në të cilën ishte vet gjyqtari, dhe e njëjta ka ndikuar qe gjyqtari Xxxxx të jetë shumë i stresuar dhe shqetësuar, dhe e gjithë kjo përkundër faktit qe gjyqtari gjithmonë duhet te jetë në nivel të duhur, ka ndikuar te gjyqtari dhe për këtë kishte pasur komunikim jo të duhur me gazetarin, dhe se nuk ka qenë sa duhet i kujdesshëm rreth sjelljes së tij, jo i vëmendshëm sa duhet me rastin e shfaqjes në publik dhe në takim me palën e tretë.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD-nr.04/2017, date 07.03.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor;
- Xxxx xxxxx, kryetar në Gjykatën Themelore në xxxxx
- Xxxxxx xxxxx, gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në xxxxx-Dega në xxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;